

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Valdete Daka dhe Agim Maliqi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit F.Gj., nga Peja, për shkak të veprës penale të ndihmës në grabitje nga neni 329 par. 5 lidhur me par.3 dhe par.1 dhe me nenin 33 të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë ushtruar nga Prokurori i Shtetit ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.61/2014 datë 21.6.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.397/2017 datë 19.9.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 8 maj 2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit të Kosovës e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.61/2014 datë 21.6.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.397/2017 datë 19.9.2016.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.61/2014 datë 21.6.2017, i dënuari F.Gj., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale të ndihmës në grabitje nga neni 329 par. 5 lidhur me par.3 dhe par.1 dhe me nenin 33 të KPK, dhe është gjykuar me dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vite e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 9.5.2014 e tutje. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil. I dënuari është obliguar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 200 € si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktvendimin PAKR.nr.397/2017 datë 19.9.2016, e ka hedhur si të palejuar ankesën e përfaqësuesit

të palës së dëmtuar, av. T.B. dhe të përfaqësuesit ligjor të palës së dëmtuar, N. dhe A.P., të ushtruara kundër aktgjykimit të shkallës së parë.

Kundër aktgjykimit të shkallës së parë dhe aktvendimit të shkallës së dytë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit të Kosovës me parashtresën KMLP.I.nr.36/2017 datë 10.11.2017, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale me propozim që të aprovohet kërkesa e paraqitur dhe shkeljet të konstatohen.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazë.

Në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë Prokurori i Shtetit të Kosovës, duke mos precizuar shkeljet, pretendon se vendimet e të dy gjykatave janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat konsistojnë në faktin se gjykata e shkallës së parë nuk e ka zbatuar në tërësi marrëveshjen për pranimin e fajësisë edhe pse këtë marrëveshje e ka pranuar si të rregullt. Kjo sepse, sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të datës 9.6.2016, mbrojtësi i të dënuarit F.Gj., ka deklaruar se pala e akuzuar nuk e kundërshton kërkesën e palës së dëmtuar për kompensimin e dëmit. Më tutje në kërkesë Prokurori i Shtetit pretendon se konform dispozitës së nenit 233 par.12 nënpar.12.4 të KPPK, gjykata e shkallës së parë ka qenë e obliguar të vendos edhe për kërkesën pasurore-juridike të palës së dëmtuar e duke referuar marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Prokurori i Shtetit, në kërkesë, konsideron se pavarësisht fakti se pala e dëmtuar nuk ka pas të drejtë të paraqes ankesë bazuar në nenin 381 par.1 të KPPK, në rastin konkret pala e dëmtuar ka të drejtë kompensimi të dëmit shuma e të cilit është precizuar dhe palët janë pajtuar gjatë negociimit të marrëveshjes andaj edhe nuk ka pasur mundësi që pala e dëmtuar të udhëzohet në kontest civil.

Gjykata Supreme, duke vlerësuar pretendimet e potencuara në kërkesë si dhe duke u bazuar në shkresat e çështjes gjen se i dënuari F.Gj., në praninë e mbrojtësit të tij, av. N. D., ka bërë marrëveshjen për pranimin e fajësisë në seancën e shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të datës 21.6.2017 dhe se me atë rast kanë qenë prezent përveç mbrojtësit edhe prokurori i çështjes dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar, av. T.B. i si dhe përfaqësuesi ligjor i palës së dëmtuar, N.P., dhe se me këtë rast i dënuari ka qenë i njoftuar për natyrën e pranimit të fajësisë, për të gjitha kushtet e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë dhe se i njëjti me vetëdije të plotë ka nënshkruar këtë marrëveshje. Qëndron fakti se në të njëjtën seancë përfaqësuesi i palës së dëmtuar ka paraqitur kërkesën për kompensim të dëmit në shumë prej 100.000 € dhe se njëkohësisht ka deklaruar se i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe se përfaqësuesja ligjore e palës së dëmtuar N.P., ka deklaruar se pajtohet me kërkesën e paraqitur nga përfaqësuesi i saj i autorizuar. Po ashtu, qëndron fakti se i dënuari F.Gj. para kësaj seance në Prokurorin Themelore në Gjakovë, më datë 3.5.2016 ka arritur marrëveshje

mbi pranimin e fajësisë dhe se me atë rast përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, av. T.B., ka parashtruar kërkesën pasurore juridike në shumë prej 100.000 € dhe se mbrojtësi i të dëmtuarit, av. N.D., ka deklaruar se nuk e kundërshton kërkesën për kompensim dëmi.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka paraqitur përfaqësuesi i palës së dëmtuar dhe përfaqësuesi ligjor i palës së dëmtuar, ndërkaq Gjykata e Apelit të Kosovës e ka hudhur kërkesën e tyre si të palejuar, e konform nenit 381 par.3 të KPPK, nga që i dëmtuari mund të ushtroj ankesë ndaj aktgjykimit vetëm lidhur me sanksionin penal kur vepra penale është kryer kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, sigurisë së trafikut publik si dhe për shpenzimet e procedurës penale.

Kjo Gjykatë duke i vlerësuar të gjitha këto gjen se pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk qëndrojnë sepse konform dispozitës së nenit 223 par.12 pika 12.4 të KPPK, të cilit i referohet Prokurori i Shtetit kemi të bëjmë me përgjegjësinë e të pandehurit për kompensimin e të dëmtuarit dhe konfiskimin e të gjitha pasurive të cilat i nënshtrohen konfiskimit nga kapitulli XVIII i Kodit të Procedurës Penale dhe është një prej kushteve minimale të cilat duhet t'i përmbaj marrëveshja për pranimin e fajësisë. Në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesën pasurore-juridike e jo me konfiskim të pasurisë dhe rregullat të cilave i nënshtrohet konfiskimi dhe të cilat do të shërbenin për kompensimin e të dëmtuarit gjë që pretendimin e Prokurorit të Shtetit e bënë të paqëndrueshëm. Po ashtu, konform dispozitës së nenit 233 par.13 të KPPK, të drejtë ankesë kundër vendimit mbi dënimin ka ajo palë, kur konstatohet se gjykata shqipton dënim jashtë kufijve të marrëveshjes në dëm të ndonjërit prej palëve, e në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimin brenda kufijve të dakorduar sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, andaj, me të drejtë Gjykata e Apelit e ka hedhur si të palejuar ankesën e përfaqësuesit të autorizuar dhe përfaqësuesit ligjor të palës së dëmtuar.

Pretendimet se pavarësisht se nuk ka pasur të dejtë ankese pala e dëmtuar, gjykata është dashur të vendos dhe të aprovojë kërkesën për kompensim të palës së dëmtuar meqë kërkesa ka qenë e precizuar dhe atë në shumë prej 100.000 €, kjo gjykatë gjen se është i paqëndrueshëm sepse gjykatat vendosin konform dispozitave ligjore të cilat janë në fuqi dhe sipas këtyre dispozitave ligjore të cekura më lartë është e precizuar se si procedohet kur kemi të bëjmë me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, kushtet për arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë si dhe personat e autorizuar për të bërë ankesë kundër aktgjykimit të bazuar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, e në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka aprovuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë në të cilën asnjëherë nuk është cekur se i dënuari duhet të kompensoj shumën e caktuar - kërkesën pronësoro - juridike të palës së dëmtuar, edhe pse avokati mbrojtës ka potencuar se nuk e kundërshton kërkesën pronësoro - juridike, gjë që nuk do të thotë se është pajtuar ta kompensoj këtë kërkesë, andaj edhe me të drejtë gjykata e shkallës së parë palën e dëmtuar për realizimin e kërkesës pronësoro-juridike e ka udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Të gjitha këto që u thanë më lart kërkesën e Prokurorit të Shtetit e bëjnë të pabazuar dhe nga këto arsye e njëjta u konsiderua si e pabazë dhe u refuzua e konform nënti 437 të KPPK, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË  
Pml.nr.89/2018, më 8 maj 2018

Procesmbajtësi,  
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,  
Nesrin Lushta